

**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ .2020

**Lënda :** Informacion për realizimin e treguesve financiarë të Radiotelevizionit Shqiptar për 3-mujorin e parë të vitit 2020.

Drejtuar : **KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH**

**Zotit Thoma GËLLÇI  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I RTSH**

Në mbledhjen e datës 18 maj 2020, Bordi i Administrimit analizoi rezultatet financiare të Radiotelevizionit Shqiptar për 3-mujorin e parë të këtij viti, të cilat po i paraqesim në vijim:

**A.Realizimi i të ardhurave në krahasim me parashikimin gjatë 3/Mujorit të parë të vitit 2020, u realizuan 94% , me një mosrealizim prej rreth 39 milionë lekë.**

Në 000/lekë

Nr	Emertimi	Planifikimi Viti 2020	Parashik .3 muj.I Viti 2020	Realizimi 3 muj.I Viti 2020	Real. ne %
<b>I.</b>	<b>Financimi nga buxheti</b>	<b>634,000</b>	<b>190,550</b>	<b>190,550</b>	<b>100</b>
	Bashkatdhetarët&Sateliti	270,000	85,000	85,000	100
	Projekte Filmike&Artistike	60,000	-	-	
	Orkestra Simfonike RTSH	54,000	15,000	15,000	100
	Shërbim mirëmbajtje rrjeti digjitaliz.,etj	180,000	60,000	60,000	100
	Investime në Teknologji	70,000	30,550	30,550	100
<b>II.</b>	<b>Të ardhura nga tarifa aparatit TV.</b>	<b>1,420,000</b>	<b>355,000</b>	<b>319,400</b>	<b>90</b>
<b>III.</b>	<b>Të ardhura te institucionit</b>	<b>346,000</b>	<b>60,000</b>	<b>56,765</b>	<b>95</b>
	Sherbim ambjente transmetuese,tr.fm	150,000	38,000	37,466	99
	Reklama,njoftime etj.	150,000	15,000	13,299	89
	Të ardhura të tjera	46,000	7,000	6,000	86
	<b>TOTALI</b>	<b>2,400,000</b>	<b>605,550</b>	<b>566,715</b>	<b>94</b>

**1.Të ardhurat nga buxheti janë realizuar në masën 100%.**

**2.E ardhura nga tarifa e përdorimit të aparateve televizive** është realizuar në masën 90% në krahasim me parashikimin. Arketimi i tarifës në muajt janar e shkurt ka qenë në nivele me të larta, ndërsa në muajin mars dhe prill vlerat kanë rezultuar me pak se parashikimi, duke krijuar një mosrealizim prej rreth 36 milionë lekë.

**3.Të ardhurat e realizuara nga vetë RTSH**





**a. Të ardhurat nga shërbimi në ambjentet transmetuese të RTSH dhe transmetime fm** janë realizuar në masën ~99% si tremujor. **Risku i realizimit në periudhën në vijim të këtij zëri vijon të parashikohet në një mosrealizim në vlerën ~25 milion lekë**, në kushtet aktuale të shtyrjes vazhdimisht të fikjes së transmetimeve analoge (parashikuar të ndodhte në mars të vitit 2020).

**b. Në zërin e reklamave, njoftimeve** etj, gjatë kësaj periudhe ka një realizim në masën 89%. Risku i realizimit të të ardhurave të këtij zëri në kufijtë e planifikimit paraqitet tepër i lartë, si rezultat i situatës së pandemisë. Arsyeja kryesore lidhet me anulimin e aktiviteteve sportive dhe artistike të rëndësishme parashikuar të transmetoheshin gjatë vitit 2020.

**c. Në zërin e të ardhurave të tjera ato** janë realizuar në nivelin 86%. Në këtë zë janë përfshirë të ardhurat nga klikimet e kanaleve të RTSH në youtube, shitja e materialeve arkivore.

### B. Realizimi i shpenzimeve në krahasim me planifikimin gjatë 3/mujorit të parë 2020 ne 000/leke

Nr	Emertimi	Planifikimi Viti 2020	Planifikimi 3/muj.I Viti 2020	Realizimi 3/muj.I Viti 2020	Real. ne %
1	Paga,shpërblime ,sig.shoqeror	827,000	195,112	191,332	98
2	Materiale,lende djegese	71,300	8,487	6,227	74
3	Projekte film.,artistike ,bl.dr.tv,f.p.pav.	314,000	77,038	75,787	99
4	Organizma Nderkombetar	87,000	10,000	9,822	99
5	Shërbime nga të tretë	280,000	48,428	46,493	96
6	Shpenzime udhëtimi e dieta	82,700	9,761	8,674	89
7	Shpenzime të tjera operative	63,000	12,674	11,431	91
8	Investime dhe miremb. rrjeti digj.	245,000	98,000	97,741	100
9	Shpenz.këste e interesa kredie	320,000	320,000	274	0,1
	<b>TOTALI</b>	<b>2,400,000</b>	<b>779,750</b>	<b>447,781</b>	<b>57</b>

Nga të dhënat e mësipërme shpenzimet janë realizuar në masën 98%.

Në mënyrë analitike realizimi i çdo zëri paraqitet si vijon :

**\*Zëri Paga, sigurime shoqërore e shpërblime** është realizuar në masën 98% .Çdo ndryshim strukturor është duke u ndjekur paraprakisht edhe me efektin në vlerë që do të sjellë në fondin e pagave. Në total fondi i pagave, sig.shoqërore e mbikohës është brenda parashikimit.

Aktualisht risku i këtij zëri qëndron në ndryshimet strukturore, të cilat kërkojnë shtesë fondesh, ndërsa mundësitë e realizimit të të ardhurave qëndrojnë në kufij të limituar.

**\*Zëri Materiale** përfshin shpenzimet për blerjen e materialeve kryesore teknike, materiale ndihmëse dhe lëndë djegëse(karburant). Realizimi i këtij zëri është në masën 98%, i pritshëm të realizohet në total në periudhën në vijim.

**\*Zëri i projekteve Filmike dhe Artistike dhe blerjet e të drejtave tv e të transmetimit** , përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e të drejtave të transmetimit, dokumentarë, filma, programe sportive, artistike, shpenzimet për projektet e miratuara. Realizimi në total i këtij zëri është në masën ~99.





**\*Zëri i Organizmave Ndërkombëtare** përfshin të gjitha shpenzimet që RTSH kryen ndaj organizmave ndërkombëtare, si Eutelsat, Ses Astra, për shërbimin satelitor, EBU për pagesat për transmetime në radio, televizion, lajme, të drejta transmetimi të programeve e aktiviteteve të ndryshme artistike dhe sportive dhe pagesat e pjesëmarrjes. Realizimi i këtij zëri gjatë kësaj periudhe është në masën 99%.

**\* Zëri i Shërbimeve nga të tretë** përfshin shpenzimet për shërbime të një natyre të përgjithshme që kryhen nga të tretët për funksionimin e përditshëm të veprimtarisë së RTSH, si shpenzimet për energji elektrike, ujë, shpenzimet telefonike, shpenzimet për ruajtjen e sigurisë fizike të objekteve të RTSH, qera të ambjenteve, etj. Realizimi i këtij zëri është në nivelin 96% , i pritshëm për t'u realizuar 100% sipas planifikimit deri në fund të vitit, pasi edhe shpenzime të larta parashikohen gjatë periudhës në vijim.

**\*Zëri i shpenzimeve Udhëtim e dieta** është realizuar pothuaj në nivelin 89%, brenda kufijve të planifikimit në të gjitha drejtoritë e njësitë e sistemit, i pritshëm të ketë tendencë ulje gjatë tremujorit të dytë, por duke u mbajtur brenda kufijve të planifikimit.

**\*Zëri i shpenzimeve të tjera Operative** është realizuar në nivelin 81%. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet për pritje e përcjellje në Drejtorinë e Përgjithshme, shpenzimet për honorare në të gjitha drejtoritë e sistemit si edhe shpenzimet për taksa, tatime etj.

**\*Zëri i shpenzimeve për Investime dhe shërbimi i mirëmbajtjes së rrjetit të digjitalizimit** është realizuar në nivelin 100%.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer pagesat për shpenzime të mirëmbajtjes së rrjetit për periudhën tetor-dhjetor 2019, pjesërisht kontrata e investimit RTSH Agro në vlerën 30,5 milionë lekë si edhe diferenca të procedurave të investimeve mbartura nga vitit 2019.

**\*Zëri i shpenzimeve për këste e interesa kredie.** Gjatë kësaj periudhe janë likuiduar kuota të kontratës së huasë, ndërsa si rezultat i mungesës së të ardhurave në momentin e pagesës së kredisë, pagesa e planifikuar në muajin mars 2020 u krye nga Ministria e Financave si garantues i kredisë.

*Në mënyrë të përmbledhur, duke analizuar situatën e deritanishme të të ardhurave dhe shpenzimeve, risku i realizimit të buxhetit të RTSh gjatë këtij viti paraqitet tepër i lartë.*

*Në këto kushte, ashtu sikurse gjatë tremujorit të parë, edhe gjatë periudhës në vijim do të vazhdojë të ndiqet hap pas hapi ecuria e të ardhurave dhe shpenzimeve. Krahas limitimit të shpenzimeve është ndjekur edhe praktika e likuidimit të tyre kryesisht në fund të muajit, përjashtuar këtu shpenzimet që kanë patur afate të përcaktuara.*

*Kjo si rezultat i problematikës së arkëtimit të tarifës në muajin pasardhës, si edhe i të ardhurave të tjera që në tremujorin e parë të çdo viti paraqiten më të ulëta.*

Në përfundim të kësaj analize, Bordi i Administrimit sugjeron:

1. Brenda muajit qershor 2020, Drejtoria Ekonomike e RTSh, të paraqesë buxhetin e vitit 2020 të rishikuar, si në drejtim të uljes objektive të zërave të të ardhurave( siç mund të jenë të ardhurat nga reklamat, publiciteti për arsye të shtyrjes së Kampionatit European të Futbollit për vitin 2021), si dhe shkurtimit të zërave të shpenzimeve (si në zërat e Projekteve artistike, udhëtim e dieta, honorare, etj).





2.Në mënyrë të përsëritur kemi theksuar nevojën e kontaktimit me drejtues të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, lidhur me arkëtimet mujore nga tarifa e përdorimit të aparateve televizive. Luhatjet e arkëtimeve midis muajve, krijojnë pasiguri në zhvillimin normal të aktivitetit të RTSH.

3.Të vijojnë përpjekjet dhe sqarimet me Ministrinë e Financave për uljen e komisionit prej 10 % që mbahet nga OSHEE si agjent për arkëtimin e tarifës së mësipërme.

4.Të synohet gjetja e burimeve alternative për rritjen e të ardhurave, siç mund të jetë nga shitja e produkteve dhe arkivës së RTSH, nga klikimet ne youtube, rritja e arkëtimeve nga të gjithë televizionet kabllore që përdorin kanale të RTSh.

5.Në mënyrë të përsëritur kemi kërkuar hartimin e projektrregulloreve për procedurat e administrimit të biletave të aktiviteteve që organizon RTSh, si dhe përmirësim të rregullave për arkëtimet nga televizionet kabllore, të cilat të paraqiten në Bordin e Administrimit brenda datës 5 qershor 2020.

6.Të vijojnë përpjekjet për arkëtimin e detyrimeve debitore, duke ndjekur procedurat ligjore.

#### BORDI I ADMINISTRIMIT

Pandi Madhi	Kryetar
Vjollca Braho	Anëtar
Adriatik Braçe	Anëtar
Albina Pulla	Anëtar
Valbona Lilaj	Anëtar

